



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Administratës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**                                              **Tiranë** \_\_. \_\_. 2020  
**Nr. Dok. 202000024/5**

**Lënda:**                      *Rekomandim për marrjen e masave nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyësor për marrjen e masave nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyësor për të orientuar drejt kërkuesin në lidhje me objektin e kërkesës së tij për informacion, në harmoni me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit në përgjithësi, dhe për informimin mbi dosjet e procedimit penal në veçanti.*

### **ARKIVIT SHTETËROR TË SISTEMIT GJYQËSOR**

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur një ankesë nga shtetasi z.V. B., në të cilën parashtrohet se i është drejtuar me kërkesë për informim, njohje dhe shfrytëzim të fondit arkivor Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor (ASHGJ), por kërkesa e tij nuk ka marrë përgjigje. Në këto kushte, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim trajtimin e ankesës së tij.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare, në përputhje me nenin 2 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ka konstatuar se *rasti plotëson kushtet për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, pasi ankuesi është shtetas shqiptar, subjekti ndaj të cilit ai ankohet është organ i administratës publike, dhe objekti i ankesës është një veprim i paligjshëm i kësaj të fundit.*

Për sa më lart, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a , ka vendosur t'a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

### ***Rrethanat e rastit***

Ankuesi i është drejtuar me kërkesë për informim, njohje dhe shfrytëzim të fondit arkivor Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor (ASHGJ), por ai ka parashtruar se kërkesa e tij nuk ka marrë përgjigje nga ky institucion.

Me shkresën nr. K3/V1-2, datë 29.01.2020 institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me kërkesë për shpjegime Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor duke kërkuar informacion si më poshtë:

1. *Nëse pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor është administruar një kërkesë për informacion, vënie në dispozicion të dokumentacionit, apo shfrytëzim të fondit arkivor nga shtetasi z. V. B.? Të na përcillet kopje e akteve administrative.*
2. *A është trajtuar kjo kërkesë nga autoriteti publik në përputhje me dispozitat, procedurat dhe afatet ligjore sipas legjislacionit për arkivat, për të drejtën e informimit dhe për procedurat administrative në tërësi? Të na përcillet kopje e akteve administrative.*
3. *A e disponon institucioni juaj dokumentacionin/informacionin e kërkuar nga ankuesi?*
  - *Në rast se po, a ka kufizime për vendosjen e tij në dispozicion të ankuesit në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”? Nëse rast se nuk ka kufizime, a është vendosur dokumentacioni/informacioni i kërkuar në dispozicion të ankuesit? Në rast se ka kufizime, na sqaroni cilat janë ato dhe nëse i janë bërë me dije ankuesit? Të na përcillet kopje e akteve administrative.*
  - *Në rast se jo, a i është bërë me dije ankuesit ky fakt, duke e udhëzuar atë lidhur me veprimet e mëtejshme administrative, ose duke ia drejtuar kërkesën autoritetit përgjegjës, në përputhje me procedurat dhe dispozitat ligjore? Të na përcillet kopje e akteve administrative.*
4. *Bazën ligjore në të cilën janë bazuar veprimet administrative / mosveprimet e institucionit tuaj;*
5. *Të na përcillen shpjegime me shkrime për gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve të ngritura nga ankuesi, si dhe duke na vendosur në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe aktet administrative të prodhuara apo administruara nga institucioni juaj që lidhen me këtë çështje.*

Me shkresën nr. 76/1, datë 04.02.2020 të ASHGJ jemi informuar se ankuesi ka depozituar pranë ASHGJ një kërkesë më datë 07.08.2019. Kësaj kërkesë i është kthyer përgjigje nga ASHGJ me shkresën nr. 381/1, datë 09.08.2019, përmbajtja e së cilës është si më poshtë vijon:

*“ ... I nderuar z. B.,*

*Në përgjigje të kërkesës suaj, datë 07.08.2019, drejtuar Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, ku kërkonte t’ju vëmë në dispozicion dosjen e plotë të gjykimit nga Gjykata e Lartë Ushtarake për dëshmoren R. GJ.dhe heroin e Popullit Z. K., ju bëjmë me dije se dosja e sipërcituar nuk është transferuar pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor. ...”*

Në shpjegimet e përcjella nga ASHGJ për institucionin e Avokatit të Popullit theksohet se përgjigja që i është dërguar ankuesit është kthyer përsëri nga shërbimi

postar për shkak të adresës së pasaktë, dhe se ankuesi nuk është paraqitur në asnjë rast pranë ASHGJ. Bashkëlidhur përgjigjes është dërguar edhe fotokopja e zarfit të kthyer nga shërbimi postar.

Në ankesën e depozituar pranë institucionit tonë, ankuesi shprehet: *kërkoj të më vihet në dispozicion procesi gjyqësor i Gjykatës së Lartë Ushtarake: Dosja Hetimore e Prokurorisë dhe Dosja Gjyqësore e rigjykitimit të vendimit të Brigadës V-të, gjyqit partizan.*

### ***Baza ligjore e aplikueshme***

Institucioni i Avokatit të Popullit nisur nga natyra e kërkesës së ankuesit, vlerëson se ajo është tepër komplekse dhe si e tillë duhet të trajtohet në mënyrë të kujdesshme, duke harmonizuar njëkohësisht dispozitat e legjislacionit procedural penal, të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të organizimit dhe funksionimit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, si edhe të veprimtarisë administrative në përgjithësi.

E drejta e informimit për dokumentet zyrtare është një e drejtë e individit e cila lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procedurave administrative. Për këtë arsye ajo është një e drejtë e mbrojtur dhe garantuar nga aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 19), Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10). Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh për të drejtën e informimit, të cilat janë tregues i kuptimit që ka ky organizëm mbi këtë çështje, dhe që shërbejnë si udhërrëfyes për vendet anëtare për rregullimin e kësaj të drejte. Po kështu, nisur nga rëndësia parësore që e drejta e informimit ka për zhvillimin e demokracisë së një vendi, Këshilli i Evropës ka miratuar një Konventë të posaçme "Për aksesin në dokumentet zyrtare".

E drejta e informimit është sanksionuar edhe në rendin e brendshëm të juridik të Republikës së Shqipërisë, pasqyruar në Kushtetutën e RSH (neni 23) dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ligji nr. 119/2014, rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike (neni 1 i ligjit).

Institucioni ynë vlerëson se për të adresuar drejt e në përputhje me dispozitat ligjore rastin, është e nevojshme të arsyetohet qartë dallimi mes "*Informacionit publik*" në kuptim të legjisacionit për të drejtën e informimit, dhe akteve të dosjes hetimore e gjyqësore, të cilat janë objekt i kërkesës për informacion të ankuesit.

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 2, pika 2 përcakton se: "***informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik***" Nisur nga ky përkufizim, në dukje aktet e dosjes hetimore dhe ato të dosjes gjyqësore janë informacion publik. Megjithatë pavarësisht sa më lart, e drejta e informimit nuk është një e drejtë e pakufizuar, e pikërisht për këtë arsye legjislatori në

dispozitën e nenit 17 të ligjit të sipërcituar ka parashikuar shprehimisht edhe rastet e kufizimit të kësaj të drejte.

Në rastin në fjalë, dokumentacioni objekt i kërkesës për informacion nuk është vetëm objekt i ligjit të sipërcituar, por edhe i legjislacionit të posaçëm procedural penal. Konkretisht, dispozitat e neneve 103, 104 e 105 të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë se:

#### Neni 103

*Ndalimi i publikimit të aktit*

- 1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.*
- 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.*
- 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.*
- 4. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.*

#### Neni 104

*Shkelja e ndalimit të publikimit*

- 1. Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një enti publik, kur nuk përbën veprë penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore.*

#### Neni 105

*Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve (Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

- 1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.*
- 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.*
- 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.*

Pra, ligji procedural penal me të drejtë ka përcaktuar rregulla të veçanta dhe kufizime në lidhje me publikimin apo dhënien e informacionit nga dosjet hetimore apo ato gjyqësore. Marrja e akteve të veçanta nga dosjet hetimore apo ato gjyqësore realizohet vetëm me autorizimin paraprak të organit të prokurorisë apo të gjykatës. Ky është një kufizim i

kuptueshëm dhe në harmoni të plotë jo vetëm me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, por mbi të gjitha për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Por, nga ana tjetër, ligji parashikon se ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.

Në këto kushte, vlerësojmë se ligji i aplikueshëm që shtrin efektet edhe për dokumentacionin objekt kërkimi nga ana e ankuesit është Kodi i Procedurës Penale, i cili është legjislacioni i kohës në fuqi në momentin që ka lindur kërkesa.

Megjithatë, pavarësisht kufizimit që ekziston për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga ankuesi, duhet theksuar Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Organizimi dhe funksionimi i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor rregullohet nga ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, si edhe nga Vendimi nr. 888, datë 31.12.2019 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”.

Neni 18/4, i ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, parashikon se:

*Neni 18/4*

*Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor*

*(shtuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)*

*Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor organizohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave*

Sipas vendimit nr. 888, datë 31.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor është institucion publik buxhetor, në varësi të ministrit të Drejtësisë i cili ka për mision ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor e hetimor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit nga gjykatat dhe prokuroritë, sipas ligjit për arkivin (pika 6 e Kreut II të VKM nr.888/2019).

Ligji për të drejtën e informimit ka disiplinuar edhe mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion në rastet kur autoriteti publik nuk e zotëron informacionin/dokumentacionin e kërkuar, sanskionim i cili është në përputhje me frymën dhe dispozitat e akteve ndërkombëtare në fushën e të drejtës për informim.

Neni 12, pika 2 e këtij ligji parashikon se:

*2. Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.*

*3. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.*

Neni 17, pika 6 e këtij ligji parashikon se:

*6. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuuesit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.*

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se mosrespektimi i këtyre dispozitave nuk përbën ngushtësisht vetëm moszbatim të kërkesave të ligjit, por është tregues i qasjes që ka institucioni në drejtim të praktikave të mira administrative, në përputhje me parimet e efijencës dhe ndihmës aktive që organi publik i jep palëve të treta.

Dispozitat e mësipërme synojnë ndërgjegjësimin e institucioneve publike për trajtimin e kërkesave për informacion, në përputhje me parimet e veprimtarisë administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative (KPrA). E drejta e informimit në Kodin e Procedurave Administrative, përveçse shfaqet si një parim i veçantë (neni 6), harmonizohet në tërësi me parimet në të cilët organet publike duhet t'a bazojnë veprimtarinë administrative, veçanërisht me parimin e dhënies së ndihmës aktive dhe parimin e deburokratizimit e efijencës (nenet 10 dhe 18 të KPrA).

Procedurat e shpejta dhe efikase nxiten edhe nga delegimi i përmirësuar i kompetencave vendimmarrëse brenda organeve të administratës publike, ndaj në këtë kuptim ligji ka për qëllim që t'i garantojë kërkuuesit për informacion të drejtën për të marrë pjesë në një procedurë administrative efijente, në të cilën janë vetë organet e administratës ato që bashkërendojnë punën për të arritur qëllimin e kërkuar, dhe jo e kundërta. Qëllimi i këtij rregullimi ligjor, që ngarkon organet publike me detyrimin për të bashkërenduar punën me qëllim vënie e informacionit/dokumentacionit në dispozicion të kërkuuesit, është që kërkuuesi të mos "gjurmtojë" institucionet publike për të siguruar informacionin e kërkuar, (siç edhe po ndodh në rastin konkret).

Organi publik duhet t'i ofrojë ndihmë palës nëse është e nevojshme. Kjo kërkon jo vetëm një sjellje të punonjësve publikë të orientuar drejt shërbimit, por edhe kryerjen e procedurave "sa më efektive dhe sa më lehtë të jetë e mundur". Organi publik "siguron" që palëve t'u jepet çdo ndihmë, veçanërisht të gjitha informacionet e nevojshme për "ndjekjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre ligjore" (neni 10 i KPrA). Këto parashikime të dispozitave të legjislacionit procedural administrativ përbëjnë parime, të cilat duhet të materializohen duke përdorur diskrecionin procedural dhe organizativ gjatë kryerjes së procedurave administrative. Parimi i shpejtësisë dhe efektivitetit nuk përjashton ekzistencën e disa hapave thelbësorë proceduralë që mund të jenë pak a shumë formalë, kur është e nevojshme për të garantuar ligjshmërinë dhe themelin e veprimit përfundimtar, në përputhje me parimet administrative të hapësirës administrative evropiane. Shteti i së drejtës është parimi mbizotërues për të gjitha veprimet administrative, e theksuar kjo në mënyrë të shprehur në nenin 4 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas së cilës zhvillimi i një procedure administrative në përputhje me të drejtat dhe interesat e ligjshme të palës, përbën në thelb të drejtën për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative.

Detyrimi i organeve të administratës publike për dhënien e ndihmës aktive dhe respektimin e parimit të deburokratizimit dhe efikasitetit në procedurat administrative duhet të konsiderohet si pjesë thelbësore e “administrimit të mirë” dhe e kërkesave të akteve ndërkombëtare dhe të Kushtetutës së Shqipërisë në fushën e të drejtës për informimin e qytetarëve.

### ***Vlerësimi i institucionit të Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime***

Pas përgjigjes së përcjellë nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, në analizë të legjislacionit procedural penal në fuqi, të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar që rregullon të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, dhe të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton dhe vlerëson sa më poshtë vijon.

Qendrimi i mbajtur nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor me shkresën nr. 381/1, datë 09.08.2019, nëpërmjet së cilës i bëhet me dije ankuesit se dokumentacioni/informacioni i kërkuar nuk është transferuar pranë këtij institucioni, përbën mosrespektim të të drejtës për informim me anë të mosveprimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Në këtë përgjigje nuk parashtrohen shpjegime apo argumenta të cilat të trajtojnë çështjen e kufizimit të të drejtës për informim mbi dosjet hetimore apo ato gjyqësore, ashtu sikundër u shpjegua në hyrje të këtij rekomandimi, për t’i dhënë ankuesit efektivisht mundësinë që të jetë i informuar se ku duhet të drejtohet për të marrë informacionin e kërkuar.

Për më tepër, duhet theksuar se nga legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e ASHGJ (cituar më lart) rezulton e qartë se ai është autoriteti që duhet të ketë në administrim dokumentacionin e kërkuar. Në këto kushte, ky autoritet ka detyrimin funksional për të orientuar drejt kërkuesin lidhur me fondin arkivor ku gjendet dosja e kërkuar.

Për këtë çështje autoriteti nuk ka informuar as ankuesin e as institucionin e Avokatit të Popullit. Në përgjigjen e përcjellë institucionit tonë, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor përcjell shpjegime të detajuara për arsyet pse përgjigja drejtuar ankuesit nuk ka mbërritur në adresë të tij, por nuk shprehet lidhur me pyetjen e parashtruar nga institucioni i Avokatit të Popullit në kërkesën për shpjegime: *“A e disponon institucioni juaj dokumentacionin/informacionin e kërkuar nga ankuesi? Në rast se jo, a i është bërë me dije ankuesit ky fakt, duke e udhëzuar atë lidhur me veprimet e mëtejshme administrative, ose duke ia drejtuar kërkesën autoritetit përgjegjës, në përputhje me procedurat dhe dispozitat ligjore? Të na përcillet kopje e akteve administrative.”*

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

## **REKOMANDOJMË:**

*Marrjen e masave nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyësor për të orientuar drejt kërkuesin në lidhje me objektin e kërkesës së tij për informacion, në harmoni me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit në përgjithësi, dhe për informimin mbi dosjet e procedimit penal në veçanti.*

*Për qendrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, lutemi na ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.*

*Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.*

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**KOMISIONERI**

**Prof. Asoc. Dr., Erjona Bana (Canaj)**